

HAPET PEDIATRIA E RE NË QSUT



Hapet Pediatria e re në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë, pjesë e investimeve të qeverisë për modernizimin e qendrës më të madhe spitalore në vend. Spitali i ri pediatrik do të ofrojë kushte me standarde europiane në tre

shërbime: Urgjencën, Reanimacionin dhe Kirurgjinë infantile. Investimi në kompleksin pediatrik do të vijojë edhe me reabilitimin e godinës ekzistuese dhe në total për dy fazat e projektit, vlera e financimit është 15 milion euro.v



FUQIZOHET FLOTA E URGJENCËS KOMBËTARE

Shërbimi i Urgjencës Kombëtare në territor u fuqizua me 20 autoambulanca të reja, pjesë e investimeve strategjike të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për modernizimin e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. Flota e re e autoambulancave do ti shërbejë një përgjigje më të mirë dhe të shpejtë të emergjencave në të gjithë vendin, duke përfshirë edhe përbalimin e pandemisë Covid-19. Më shumë se 100 autoambulanca të reja, plotësisht të pajisuara janë investuar nga qeveria shqiptare në katër vitet e fundit, duke e ngritur në një nivel të ri shërbimin e urgjencës kombëtare.

SHËRBIMI I RI KARDIOKIRURGJISË NË SPITALIN ‘SHEFQET NDROQI’

Në spitalin ‘Shefqet Ndroqi’, është hapur qendra e dytë e shërbimit të kardiokirurgjisë në vend. Investimi për krijimin e kësaj Njësie të re, përfshin sallën e re të operacionit, njësinë e veçantë të reanimacionit si dhe të gjithë pajisjet mjekësore të teknologjisë së fundit. Shërbimi i ri kardiokirurgjisë në këtë spital universitar, synon rritjen e aksesit të qytetarëve për ndërhyrjet falas në zemër. Hapja e këtij shërbimi, i dyti në rang vendi në spitalet publike, do të përmirësojë ndjeshëm trajtimin e pacientëve, duke plotësuar nevojat për ndërhyrjet në zemër në strukturat publike. Në këtë Njësi të re të kardiokirurgjisë parashikohen të kryhen 400 ndërhyrje në vit.

STRATEGJIA KOMBËTARE E SHËNDETËSISË 2021-2030

Prezantohet Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030, një document i rëndësishëm që reflekton programin qeverisës “Shqipëria ‘20-30”. Komponentët kryesorë të kësaj strategjie janë: Investimi në shëndetin e njerëzve gjatë gjithë ciklit të jetës; mbulimi shëndetësor universal; fuqizimi i sistemit të integruar shëndetësor; fuqizimi i reagimit të sistemit ndaj emergjencave dhe shëndetësia digjitale. Me synim drejt mbulimit shëndetësor universal, objektivi është që mbi 70% e shpenzimeve për shëndetin të mbulohej nga financimi publik. Strategjia e Shëndetësisë 2021-2030 është hartuar nga ekspertët më të mirë vendas, me asistencë ndërkombëtare. Prezantimi i draftit të strategjisë u diskutua me grupet e interesit, përfaqësues të stafëve mjekësore, shoqatat e pacientëve dhe partnerët ndërkombëtarë.

FËMIJËT NË PËRKUJDESJE TË REPUBLIKËS

Për të garantuar mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve që kanë humbur prindin në krye të detyrës dhe që shpallen “Dëshmorë të Atdheut”, qeveria shqiptare ka miratuar vendimin për mbështetjen e tyre me pagën e prindit, bazuar në ligjin e ri për “Fëmijët në Përkujdesje të Republikës”. Përveç trajtimit financiar, këta fëmijë do të kenë mbështetje për edukim e arsimim, punësim, mbrojtje sociale dhe në shërbimin shëndetësor publik e privat.

RRITET PAGESA E NDIHMËS EKONOMIKE

Duke filluar nga Janari i vitit 2022, hyn në fuqi rritja e masës së ndihmës ekonomike për të gjitha familjet përfituese të skemës, sipas kategorive. Do të dyfishohet masa e ndihmës ekonomike për rreth 15 mijë familje, të cilat kanë mbi 3 fëmijë deri në 18 vjeç. Do të trefishohet masa e ndihmës ekonomike për fëmijët me status jetimi, për gratë e trafikuar dhe të dhunuara. Do të rritet për pjesën tjetër të përfituesve me 10% masa e ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes. Për programin e ndihmës ekonomike, buxheti është rritur me rreth 15 milionë dollarë